



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 19.01.2026
Numër Protokolli: 293/2026

A.nr.2014/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2014/2025, të datës 10.12.2025, të parashtruar nga ankuesja V.K, kundër organit të punësimit/ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 19.01.2026, mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me A.nr.2014/2025, e datës 10.12.2025, e parashtruar nga ankuesja V.K.

A r s y e t i m

Ankuesja, V.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuese), më datë 10.12.2025, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.2014/2025, kundër përzgjedhëses përfundimtare të kandidatit fitues me vendimin e datës 21.05.2025, për pozitën “Zyrtar për Analiza Laboratorike”, të shpallur nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë/ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.12.2025, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ndërsa, ky i fundit, më datë 13.01.2026 ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.2014/20256 të datës 10.12.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 05.05.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Njoftimi për kandidatin fitues i datës 21.05.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Konkursi me numër reference RN00016816, i datës 24.02.2025; Konkursi me numër reference RN00016819, i datës 24.02.2025; Kopje e Letër njoftimit për ankuesen; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 17.12.2025; Përgjigje në ankesë me numër protokolli A.nr.2014/2025, e datës 13.01.2025; Vendimi me numër protokolli 7997/2025, i datës 31.10.2025; Njoftimi i datës 31.10.2025, i nxjerr nga i Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesja V.K, është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, me datë 24.02.2025 ka shpallur konkursin e jashtëm me numër të referencës RN00016816 „për Grupin Grupi i Shkencave Natyrore, për pozitën “ Zyrtar për Analiza Laboratorike”, klasa Profesional 2 , një vend pune, i hapur për aplikim nga data 25.02.2025–26.03.2025, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Tutje, Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, më datë 21.05.2025,, ka publikuar njoftimin lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare, për pozitën “Zyrtar për Analiza Laboratorike”, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja L.K, është vlerësuar me gjithsejtë 91 pikë.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 21.05.2025, lidhur me përzgjedhjen e kandidates së suksesshme me datë 10.12.2025, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër anulimit të kontratës së kandidatit fitues me vendimin e datës 21.05.2025 për pozitën “Zyrtar për Analiza Laboratorike” me numër të referencës RN00016816 dhe se konsiderojë se vendimi i datës 21.05.2025, për përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozitën ‘Zyrtar për Analiza Laboratorike’, me numër të referencës RN00016816 në të cilin konkurs kam qenë pjesëmarrëse e konkursi dhe pjesë e intervistës me gojë është shpallur në ditën e njëjtë me konkursin ‘Zyrtar për Analiza Laboratorike të Ujit, me numër reference RN00016819 dhe se nga vendimi i ankesës A. Nr. 1595/2025 e parashtruar nga unë është refuzuar si e pa bazuar për shkak të Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, ka qenë pa mandat atëherë edhe vendimi për përzgjedhjen përfundimtare për pozitën “Zyrtar për Analiza Laboratorike” me numër të referencës RN00016816 duhet të shpallet i pavlefshëm sepse është nga i njëjti zyrtar pa mandat.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*”, si dhe në kundërshtim me nenin 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *Ankesa në procedurë pranimi. 1. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve*, prandaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë me datë 21.05.2025 ka publikuar njoftimin lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare, për pozitën “Zyrtar për Analiza Laboratorikë”, sipas konkursit me numër referencë RN00016816 ndërsa ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e ka parashtruar me datë 10.12.2025, me numër protokolli 7806/2025, e që është jashtë afatit të përcaktuar ligjor për parashtrimin e ankesave, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit.

Ndërlidhur me ankesën e ankueses të parashtruar në Këshilli, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja ka qenë e obliguar që ankesën ta parashtrojë në pajtim me Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit nr. 08/l-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, në afatin prej (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për rezultatin përfundimtare për pozitën për pozitën “Zyrtar për Analiza Laboratorikë”, prandaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore tjera të ankueses, sepse ankesën e ka parashtruar jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
LËNDA Nr. A. nr. 2014/2025

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, V.K;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së